

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
NR 6071 VENDIMI

6071  
P

V E N D I M  
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot date 31.08.1994 ne Gjykatën e rrethit të Tiranës, une gjyqtarja  
mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga AGIM BUXHELI, i biri i  
Avniut, lindur 1955, per regjistrimin si person juridik, te shoqerise me  
pergjegjesi te kufizuar, "RUDINA" SHPK,

V E R E J :

Kerkuesi AGIM AVNI BUXHELI ka paraqitur kerkese per regjistrimin si  
person juridik, te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin  
"RUDINA" SHPK, me ortak te vetem kerkuesin AGIM BUXHELI, me seli ne Tirane  
per nje periudhe 10 vjecare, me kapital 100.000 leke, me objekt veprimtarie  
fushen e ndertim montimit e prodhime konstruksione, me administrator  
ortakun e vetem , AGIM BUXHELI, prodhime konstruksione artizanale.

Kerkesa eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar.

PER KATE ARESYE:

Ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 dhe ligjit Nr.7667, date  
28.1.1993,

V E N D O S A :

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufi-  
zuar, me emertimin "RUDINA" SHPK, me seli ne Tirane, me afat 10 vjet, me ka  
pital 100 000 leke, me objekt veprimtarie ne fushen e ndertim montim e  
prodhime konstruksione, me ortak dhe administrator AGIM AVNI BUXHELI.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne shkalle te dyte.

G J Y Q T A R J A

*Prills Cepo*

*Agj*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT TIRANË

Nr. 6071/1

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 14.06.1995 unë gjyqtare e vetme e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Anila Capo, mora në shqyrtim kërkesën e ortakut të vetëm të shoqërisë "RUDINA" shpk dhe ;

K O N S T A T O V A :

Se kërkesa e kërkuarit Agim Buxheli, ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "RUDINA" shpk, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, me numer vendimi 6071, datë 31.8.1994 me objekt veprimtarie në fushën e ndërtimit, montimit e prodhime konstruksione e artizanale, i cili kërkon shtese objekti edhe në fushën e bar bufe restaurant, hoteleri, prodhim dhe tregim lule me shumicë e pakicë importi dhe eksport, është e drejtë , e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 33 të ligjit 7667, datë 28.01.1993 Për shoqëritë tregtare si dhe regjistrin Tregtar e formalitetet që duhen plotësuar në të;


V E N D O S A :

Pranimin e kërkesës së ortakut të vetëm të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "RUDINA" shpk për shtese objekti dhe depozitim e vendimit të asamblese së ortakut të vetëm në skedën e regjistrin Tregtar të kësaj shoqërie në kollonën nr.2, germa e, si dhe të ndahen regjistrimet me vijë të kuqe nga njeri tjetri.

Kundër vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit.

G J Y Q T A R E

/ Anila Capo /



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
NR. 6071/1.....VENDIMIT

6231

Tirane, me 21/06/1999

**V E N D I M**  
**I**  
**GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me daten 21/06/1999, une Gjyqtare Smirë Cefa ne gjykatën e rrethit Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen paraqitur nga kerkuesi Agim Buxheli, per depozitim e dokumentave per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise "RUDINA" sh.p.k

**V E R E J**

**Agim Buxheli** eshte Ortake i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "RUDINA" sh.p.k, e miratuar me vendimin nr. 6071 date 31.08.1994 te kesaj gjykate.

Me vendimin nr. 6071/1 date \_\_\_\_\_ te po kesaj gjykate eshte vendosur dhe shtimi i objektit per ushqim social.

Me vendimin e ortakut te dates 15.06.1999 eshte vendosur ndryshimi ne Statut persa i perket shtimit te objektit te veprimtarise, ne prodhim studio.

Te reflektohen ndryshimet ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Nga dokumentat e paraqitura, rezulton se kerkesa e tij eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per Shoqerite Tregtare"

**V E N D O S A**

Pranimin e kerkeses.

Te depozitohet kerkesen dhe dokumentat e paraqitura nga kerkuesi Agim Buxheli, Ortake i Shoqerise "RUDINA" sh.p.k., per te reflektuar ndryshimet ne Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e rrethit Tirane, persa i perket ndryshimit ne Statut te shtimit te objektit te veprimtarise te saj ne kolonen 4 germa C

Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit Tirane.

**GJYQTARE**

*Smirë Cefa*  
*CC*

A K T - THEMELIMI  
i shoqerise tregtare "RUDINA" SHPK

Sot date 28.08.1994, ne Tirane :

AGIM BUXHELI, i biri i Avniut, lindur 1955 ne Tirane, banues ne Tirane rruga Qemal Stafa Nr.395, madhor, me zotesi te plote juri dike per te vepruar, me me cilesine e ortakut te vetem, shpall :

NENI 1

Themelimin e shoqerise tregtare, me emertimin "RUDINA" SHPK.

NENI 2

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "RUDINA" SHPK eshte ne Tirane, rruga Fabrika e Kepuceve, ish pularia Tirane.

NENI 3

Afati i ushtrimit te veprimtarise eshte 10 vjet.

NENI 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i formuar dhe i nenshkruar ne mase te plote nga ortaku i vetem AGIM BUXHELI.

NENI 5

Objekt veprimtarie eshte fusha e ndertim, montimit e prodhime konstruksione. artizanale.

NENI 6

Administrator i saj eshte pronari dhe ortaku i vetem AGIM BUXHELI.


ORTAKU I VETEM

AGIM AVNI BUXHELI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE

NR 439 NR 204 V E R T E T I M

Sot date .08.1994 (nentedhete e kater) ne zyren e noterise ne Tirane u paraqit AGIM BUXHELI, madhor, me zotesi te plote juridike, per identitetin e te cilit u sigurova me leternjoftimin, me me deklaroi se ky eshte akt themelimi, formuluar jashte kesaj zyre, me vullnet te lire dhe te plote te tij, qe nenshkroi rregullisht dhe me noterija e vertetoj ate sipas ligjit.



S T A T U T

I

shoqerise tregtare "RUDINA" SHPK

THEMELIMI

NENI 1

Themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar, me emertimh "RUDINA" SHPK, me ortak te vetem , z. AGIM AVNI BUXHELI.

SELIA

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, rruga Fabrika e kepuceve, ish pula ria, Tirane. Ajo mund te cele edhe qendra te tjera, brenda e jashte vendi.

KOMEZGJATJA

NENI 3

Shoqeria do te veproje per nje periudhe 10 vjecare.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekt veprimtarie i shoqerise eshte fusha e ndertim montimit e prodhime konstruksione, artizanale.

KAPITALI

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke i formuar ne mase te plote dhe i nenshkruar nga ortaku i vetem AGIM BUXHELI.

NENI 6

Kapitali mund te shtohet me vendim te ortakut te vetem.

NENI 7

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, objektin , numrin e ortakëve me vendim te ortakut te vetem.

- % -



DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 8

Organ vendimor i shoqerise eshte ortakut i vetem AGIM BUXHELI.

NENI 9

Administrator i shoqerise eshte pronari i saj, AGIM BUXHELI.

NENI 10

Perfaqesimi i shoqerise i perket ortakut te saj te vetem.

Ai ka te drejte te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet e saj me te tretet, ne organe administrative, shteterore , gjyqesore etj.

NENI 11

MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private.

Ajo merr persiper te drejta dhe detyrime brenda kapitalit te saj themeltar.

NENI 12

Shoqeria eshte prone e ortakut te saj te vetem AGIM BUXHELI.

NENI 13

Shoqeria mund te cele llogari te saj ne leke dhe ne valute, ne bankat shqiptare e te huaja, ne vend ose jashte tij.

NENI 14

Shoqeria ka te drejten e tjetersimit, te disponimit dhe te perdorimit te pasurive te veta ne perputhje me qellimet e saj.

NENI 15

Shoqeria ka te drejte te lidhe kontrata me shoqerâ te tjera shteterore e private , shqiptare e te huaja, brenda e jashte vendit.

NENI 16

Per pasqyrimin e veprimtarise do te mbahet dokumentacion i rregullt

MARREDHNIET E PUNES

NENI 17

Marretheniet e punes rregullohen sipas ligjeve ne fuqi dhe kontrates se punes qe lidhet me te punesuarit, ku percaktohet lloji i punes, koha e punes dhe paga.

NENI 18

Pagat e punes percaktohen ne perputhje me treguesit ekonomiko-financiare te shoqerise por ato nuk mund te jene me te ulta se ato te percaktuara nga ligji perkates.

NENI 19

Ndryshimet ne vendim e punes per punonjesit behet me urdher te ortakut te vetem. Largimi i tyre behet me vullnetin e tyre, kur ka mbaruar afati sipas kontrates se lidhur dhe dokument te noteruar.

NENI 20

Ne kete shoqeri mund te punesohen persona fizike e te huaj te specialitetev te ndryshpe.

NENI 21

Mosmarreveshjet midis paleve zgjidhen me mirekuptim ose ne rruge gjyqesore ne Gjykatën e Tiranës.

BILANCI DHE TE ARRSHURAT

NENI 22

Veprimtaria e shoqerise mbeshtetet ne fitim-humbjet.

llogaria mbahet ne Shqiperi.

NENI 23

Ne fund te periudhes ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin fitim- humbje, te bazuar ne ligjet e rregullat kontabile.

NENI 24

Bilanci miratohet nga ortaku i vetem.

NENI 25

Pas vecimit te fondeve te akumulimit, te pages se punonjesve dhe te detyrimeve fiskale, te sigurimeve te ndryshme, te ardhurat neto i mbeten ortakut te vetem.

NENI 26

Fitimi mund te transferohet lirisht edhe jashte shtetit.

NENI 27

SHPERBERJA

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe e per cdo shkak.

NENI 28

Ortaku i vetem vendos per menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore, duke ju vene detyra konkrete.

Ata jane pergjegjes per pasurine e shoqerise deri ne dorezimin e saj personave te trete.

NENI 29

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet ligjit tregtar ne vecanti dhe cdo ligji tjeter.

NENI 30

Statuti nenshkruhet nga ortakut i vetem, pronari i saj AGIM BUXHELI

ORTAKU I VETEM

AGIM AVNI BUXHELI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

N<sup>o</sup> 439

N<sup>o</sup> 206

V E R T E T I M

Sot date .08.1994 (nentedhete e kater) ne zyren e noterise ne Tira ne u paraqit AGIM BUXHELI, madhor, me zotesi te plote juridike, per identitetin e te cilit u sigurova me leternjoftimin e tij, qe me deklaroi se ky eshte statut i formular jashte kesaj zyre, me vullnet te lire he te plote te tij, qe nenshkroi rregullisht dhe une oterja e vertetoj ate sipas ligjit.





V E N D I M

I ASAMBLESE SE ORTAKUT TË VETËM

Sot, më datë 10.6.1995 unë ortaku i vetëm i shoqërisë "RUDINA" shpk për nevojat e mia të kësaj shoqërie e shikoj të domosdoshme që përveç objektit që kam të regjistruar në statutin e aktin e themelimit të kësaj shoqërie si dhe në vendimin e gjykatës , ku unë në skedën përkatëse kam objekt veprimtarie në fushëne ndërtimit, montimit e prodhimet e konstruksioneve artizanale ;

V E N D O S A :


Të bëjë shtese objekti të veprimtarisë së kësaj shoqërie edhe në fushën e:

- Bar bufe restorant, hoteleri, prodhim dhe tregtim lule me shumicë e pakicë, importi dhe eksporti.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

RUDINA SH.P.K.

AGIM BUXHELI



**SHOQERIA "RUDINA" SH.P.K  
TIRANE**



**V E N D I M**

**I**

**ASAMBLESE SE SHOQERISE "RUDINA" SH.P.K**

Asambleja e Shoqerise "RUDINA" SH.P.K., e perbere nga Ortaku i Vetem z. Agim Buxheli, u mblodh sot me daten 15.06.1999 dhe me pjesemarrjen e plote te kapitalit themeltar,

**V E N D O S I**

Ndryshimin ne Statut persa i perket shtimit te objektit te veprimtarise se shoqerise "RUDINA" sh.p.k., ne prodhim studio.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere dhe i paraqitet gjykates per ta miratuar konform dispozitave ligjore per te bere ndryshimet perkatese.

**ORTAKU I SHOQERISE**

**AGIM BUXHELI**

*Agim Buxheli*

*Agim*

6021/7  
6831



**K E R K E S E**

**K E R K U E S I** : **AGIM BUXHELI**, i biri i Avniut, dtl. 1955, banues ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.  
Ortake i Shoqerise "RUDINA" sh.p.k  
**O B J E K T I** : Ndryshimin ne Statut persa i perket shtimit te Objektivit te veprimtarise se Shoqerise "RUDINA" sh.p.k

**G J Y K A T E S S E R R E T H I T**  
**T I R A N E**

Une kerkuesi, Agim Buxheli, Ortake i Shoqerise "RUDINA" sh.p.k, i paraqes kesaj gjykate vendimin e Asamblese se Shoqerise "RUDINA" sh.p.k., per ndryshimin e Statutit te kesaj shoqerie persa i perket shtimit te Objektivit te veprimtarise, ne prodhim studio.  
Kerkoj nga ana e kesaj gjykate ne baze te Ligjit 7667 date 28.01.1993 qe te me ndryshoje Statutin persa i perket shtimit te objektivit te veprimtarise ne prodhim studio te Shoqerise "RUDINA" sh.p.k., duke miratuar Vendimin e Asamblese se Shoqerise.

**K E R K U E S I**  
**AGIM BUXHELI**

*Agim Buxheli*  
*Agim Buxheli*

dt 24.07.05  
6071/54

6071

1192

K Ë R K E S E

KËRKUESI : Agim Buxheli , i biri i Avniut, dtl. 1955 lindur e banues në Tiranë, rruga Qemal Stafa, nr.395, madhor me zotesi të plotë për të vepruar.

OBJEKTI : Shtese objekti të veprimtarisë së shoqërisë tregtare "RUDINA" shpk dhe depozitimin në Regjistrin tregtar të vendimit të asamblese se ortakut të vetëm.

*Co depozituar  
14.06.95*

PËRPARA GJYKATËS SË RRETHIT

T I R A N Ë

Unë ortaku i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "RUDINA" shpk të regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së rrethit Tiranë, me numer vendumi 6071, datë 31.8.1994 me objekt veprimtarie në fushën e ndërtim, montimit e prodhime konstruksione e artizanale. Me vendimin e asamblese se datës 10.6.1995 kam vendosur shtese objekti edhe në fushën e trëgtim e prodhime të luleve si dhe do hap një bar restorant , hoteleri. Kërkoj të depozitohen këto materiale për shtese objekti edhe në këtë fushë, pranë Zyres së Regjistrin Tregtar.

ORTAKU I VETËM

Agim Buxheli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NOTERIA TIRANË

V Ë R T E T I M

Sot, me date 14.06.1995 u paraqit para meje ortaku i vetëm i shoqërisë RUDINA shpk , madhor me zotesi të plotë juridike për të vepruar, i cili deklaroi para meje se kërkesa e mesipërme është bërë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe nënshkroi para meje.



NOTERE PUBLIKE  
FATMIRE SHEHU  
TEL 249 28



6071

K E R K E S E

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

KERKUESI : AGIM BUXHELI, i biri i Avniut, lindur ne Tirane, 1955, banues ne Tirane, rruga Qemal Stafa, Nr.395, madhor, me zotesi te plate juridike.

OBJEKTI: Regjistrimin si person juridik ne baze te ligjit nr.7638, dat 19.11.1992 dhe Nr.7667, date 28.1.1993

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

I nenshkruari AGIM BUXHELI i parashtroj asaj gjykate kerkesen time si me poshte vijon :

Kam vendosur te ushtroj veprintarine private si person juridik, ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "RUDINA" SHPK, per 12 vjet, me seli ne Tirane, me kapital themeltar 100.000 leke, me administrator kerkuesin AGIM BUXHELI, ne fushen e ndertim, montimit e prodhime konstruksione, artizanale.

Bashkengjitu keni dokumentet e kerkuara nga ligji. Ju lutemi shqyrtoni dhe miratoni regjistrimin si person juridik.

Tirane 28.08.1994

KERKUESI

AGIM AVNI BUXHELI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE

№ 460

№ 205

VERTETIM

Sot date . . . 1994 (nentedhjete e kater) ne zyren e noterise ne Tirane u paraqit AGIM BUXHELI, madhor, me zotesi te plate juridike, per identitetin e te cilit u sigurova me leternjoftimin e tij, qe me deklarise kjo eshte kerkese e formuluar jashte kesaj zyre, me vullnet te lire dhe te plate te tyre, qe nenshkrai rregullisht dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT TIRANË  
ZYRA E REGJISTRIT TREGTAR  
NR. 1182

V E R T E T I M

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "RUDINA" shpk e regjistruar në Regjistrin Tregtar të kësaj gjykate me numer vendimi 6071, datë 31.08.1994 me ortak e administrator të vetëm Agim Buxheli me kapital 100.000 lekë, me seli në Tiranë dhe me objekt veprim arie në fushën e ndërtim montimit e prodhime konstruksione artizanale

Depoziton pranë zyrës së Regjistrit Tregtar sot më datë 14.06.1995 këto materiale :

- Kërkesen e ortakut të vetëm i cili kërkon të depozitoj pranë Regjistrit Tregtar vendimin e asamblese se ortakut të vetëm.

- Vendimin e Asamblese se ortakut të vetëm Agim Buxheli të datës 10.6.1995, i cili ka vendosur për shtese objekti edhe në fushën e bar bufe, restorant, hoteleri, prodhim e tregtim lule me shumicë e pakicë, importi dhe eksporti.

PËR REGJISTRIN TREGTAR

S E K R E T A R E

/ Luljeta Ilia /